

STRATEGJIA E KE PËR ZGJERIM DHE SFIDAT KRYESORE NË VITIN 2015-2016:

Duke marrë parasysh progresin e bërë me zbatimin e marrëveshjes politike të qershorit dhe korrikut të këtij viti, Komisioni është i përgatitur të jep rekomandim për hapjen e negociatave me Maqedoninë. Ky rekomandim, megjithatë, do të kushtëzohet me zbatimin e vazhdueshëm të marrëveshjes politike të qershorit dhe korrikut dhe përparimit të konsiderueshëm në zbatimin e Prioriteteve urgjente të reformave. Kjo çështje do të rishikohet pas zgjedhjeve.

NGA RAPORTI I KOMISIONIT EVROPIAN PËR VITIN 2015:

KRITERET POLITIKE

- ▶ Sipas vlerësimeve të Komisionit për kritere politike, Maqedonia gjendet në krizën më të vështirë politike që nga viti 2001, që ka tejkaluar të gjitha kritikën e mëparshme të KE-së të përcaktuara në raportet e mëparshme. Komisioni sugjeron se me thirrjet e përgjuara është zbuluar përfshirja e zyrtarëve të lartë qeveritarë në shkeljen e të drejtave të njeriut, ndërhyrjen në pavarësinë e gjyqësorit, lirinë e mediave dhe zgjedhjet, si dhe politizimin dhe korrupsionin.

DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I SË DREJTËS

- ▶ Vendi gjendet në krizë për shkak të kulturës së ulët politike që ka çuar në ndarje mbi baza të ndryshme, dhe mungesa e kompromisit dhe dialogut, së bashku me bojkotin e parlamentit nga opozitës kanë cenuar besimin e brishtë në institucionet.
- ▶ Qeveria, Parlamenti dhe organet tjera mbikëqyrëse kanë dështuar dukshëm në ofrimin e përgjigjes së përshtatshme ndaj konstatimeve të korrupsionit dhe shkeljes së lirive të mediave prej materialeve të publikuar.
- ▶ Komisari për zgjerim bashkë me tre anëtarë të Parlamentit Evropian kanë ndërmjetësuar bisedimet politike dhe marrëveshjen në periudhën qershor/korrik.

LIRIA E SHPREHJES

- ▶ Janë regjistruar disa parashtresa për frikësim dhe ngacmim të gazetarëve, dy raporte për dëmtim të pronës dhe dy kërcënime me vdekje drejtuar kundër gazetarëve.
- ▶ Incizimet e bisedave telefonike kanë konfirmuar se gazetarët kanë qenë të përgjuar në mënyrë të paligjshme dhe kohë të gjatë, dhe kanë qenë të ndjekur disa vjet.
- ▶ Autoritetet publike kanë tendencë për përdorim të tepërt të termit dokumente "të fshehta", veçanërisht ato që lidhen me shpenzimet e projektit Shkupi 2014, për të parandaluar qasjen e publikut në informata.
- ▶ E drejta e medieve për të transmetuar informacione dhe ide që janë me interes publik dhe e drejta e publikut për ti pranuar, siç është formuluar nga KEDNJ, janë shkelur rregullisht nga ndërhyrjet politike në politikën redaktuese të medieve, sidomos në transmetuesin kombëtar.
- ▶ Nuk ka pavarësi të plotë redaktuese të RTVM, që nuk arrin të informojë publikun mbi çështjet e interesit publik, përfshirë aferën me bisedat telefonike të përgjuara.
- ▶ Stacionet më të mëdha televizive me mbulim kombëtar (Sitel, Kanal 5, Alfa dhe RTVM) raportojnë në dobi të qeverisë dhe në mënyrë selektive mbi opozitën ose aktivitetet e shoqërisë civile.
- ▶ Përmbajtja e bisedave telefonike të përgjuara zbuloi lidhje të ngushta ndërmjet Qeverisë dhe pronarëve të medieve më të ndjekura dhe qarkullim më të lartë, të cilët gjithashtu marrin pjesën më të madhe të fondeve të Qeverisë të parapara për fushatat e marketingut.
- ▶ Reklamën qeveritare janë burimi më i madh për mbledhjen e fondeve dhe kanë ndikim të madh në tregun mediatik në nivelet kombëtare dhe lokale.

ZGJEDHJET

- ▶ Në materialet e përgjuara ka biseda për manipulime me listat e votuesve, blerjen e votave, kërcënime ndaj zyrtarëve publikë dhe kompanive private, si dhe pengim i votuesve që të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar.
- ▶ Nevojitet veprim politik dhe ligjor shumë më shumë se sa miratim i ligjeve në adresimin e problemeve të tjera në këtë fushë.

KONTROLLI I SHËRBIMEVE PËR ZBULIM

- ▶ Në teori, vendi ka krijuar një sistem monitorimi, i cili në fakt nuk funksionon sa i përket strukturave të sigurisë dhe zbulimit.
- ▶ Komisionet parlamentare përgjegjëse për kontroll janë mbledhur shumë rrallë dhe në mënyrë të parregullt në vitet e fundit.
- ▶ Po këto komisione nuk kanë vepruar sipas dispozitave të tyre ligjore (deri në këtë vjeshtë), dhe nuk kanë thirrur Ministrin për punë të brendshme dhe Drejtorin e DSZ të paraqiten para tyre.
- ▶ Nuk ka përgjegjësi të mjaftueshme për shkeljet e rënda dhe përgjimet e paligjshme të qytetarëve gjatë një periudhe të konsiderueshme kohore.
- ▶ Duhet të kryhet rekomandime të qarta për mbikëqyrje dhe reformë të shërbimeve të zbulimit të përfshira në prioritetet urgjente për reformë.

REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

- ▶ Punësime me qëllim, politike dhe arbitrare kanë ndodhur në shkallë të madhe.
- ▶ Ligji për transformimin e punësimit të përkohshëm në të papërcaktuar u miratua në muajin shkurt me procedurë të shkurtuar dhe pa konsultim paraprak me publikun dhe partnerët e BE-së, pak ditë para hyrjes në fuqi të paketës së ligjeve. Akti anashkalon parimet e punësimit bazuar në merita me transformimin e mijëra kontratave të përkohshme për punësim në nëpunës të përhershëm civil apo publik, pa konkurs publik.
- ▶ U rrit numri i të punësuarve në sektorin publikë të cilët nuk janë të obliguar të paraqiten në punë.
- ▶ Numri i përgjithshëm i të punësuarve të përhershëm dhe të përkohshëm, të të gjitha llojeve, duhet rregullisht të jetë në dispozicion për publikun (sipas prioritetëve për reformë urgjente).
- ▶ Sektori publik ka akoma më shumë i fryrë nga praktika e krijimit të vendeve të reja të punës për arsye politike ose shoqërore, sidomos para se ndryshimet e reja legjislative të hyjnë në fuqi.

SHOQËRIA QYTETARE

- ▶ Sistemi për ndarjen e fondeve për shoqërinë civile mbetet i paefektshëm.
- ▶ Strategjia e qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile nuk është zbatuar në mënyrë adekuate për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe kapaciteteve administrative dhe resurseve.
- ▶ Përfshirja dhe pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile në procesin e krijimit të politikave është e papërshtatshme.

SISTEMI GJYQËSOR

- ▶ Këshilli Gjyqësor është sistematik në monitorimin sistemit dhe ekziston shqetësimi se shmangej rastet e mosmarrëveshjeve «kyç».
- ▶ Nuk ka instrument transparent për të vlerësuar nëse kriteret objektive zbatohen aktualisht në vendimet për emërimin e gjyqtarëve.
- ▶ Shkalla e ndikimit politik mbi emërimin e gjyqtarëve dhe mbi gjykimet, për të cilat më parë kishte vetëm dyshime u konfirmua nga shpallja e bisedimeve të përgjuara.
- ▶ Shqetësimet në lidhje me sigurinë e mandatit të gjyqtarëve nuk janë zvogëluar nga themelimi i "Këshillit për përcaktim të fakteve dhe nisjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësive së gjyqtarëve".
- ▶ Koha e krijimit të trupit të ri plotësisht të parapara për përgatitje të procedurave për shkarkim të gjyqtarëve duket krejtësisht e gabuar dhe paraqet një goditje shtesë për profesionin dhe është gjithashtu e bllokuar.
- ▶ Baza ligjore e gabuar për shkarkim që kërcënon pavarësinë e gjyqësorit ende nuk është larguar
- ▶ Gjatësia mesatare e procedurave, sidomos në rastet e «vjetra» shqetëson.

POLITIKA PËR LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT

- ▶ Selektiviteti në luftimin e korrupsionit, efekti është më i fuqishëm në luftën kundër korrupsionit lidhur me krimet e rënda dhe të organizuara, si dhe shpërdorimi i detyrës nga ana e zyrtarëve të nivelit të ulët dhe të mesëm, por është mjaft i dobët në luftën kundër korrupsionit politik në nivel të lartë.
- ▶ Akuzat serioze kundër zyrtarëve të lartë qeveritarë ende presin hetim të plotë. Ky mosveprim selektiv krijon shqetësim në lidhje me pavarësinë e policisë, prokurorisë dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.
- ▶ Ende pritet hetimi për akuzat e përhapura për politizim dhe ndërhyrje politike nga ana e ekzekutivit në punën e organeve ekzekutive dhe legjislative të gjyqësorit.
- ▶ Përmbajtja e bisedave të përgjuara tregon përfshirjen e anëtarëve të Qeverisë dhe zyrtarë të lartë në abuzimet e pushtetit dhe korrupsionit në prokurimin publik, planifikimin urban, financimin e partive politike dhe të punësimit publik, si dhe ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit, mediet dhe zgjedhjet.
- ▶ Evidenca mbi kontrollin e financimit të partive dhe të fushatës zgjedhore tregon se dënimet ekzistuese sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Kodit Zgjedhor duhet të zbatohen në mënyrë më sistematike dhe të dukshme në praktikë.